

TERMAT E REFERENCËS
AUDITIMI I JASHTËM VJETOR I PASQYRAVE FINANCIARE TË ORGANIZATËS

SHUKOS kërkon oferta nga kompani konsulence (auditimi) e cila do të punojë ngushtë me stafin e tij, për zhvillimin e procedurave të auditimit të jashtëm dhe hartimin e raportit të auditimit për vitin 2021 dhe dy vitete e ardhshme.

Kohëzgjatja e vlerësuar: 24 Shkurt 2022 – 02 Mars 2022

Ditët e punës: maksimum 5 ditë pune

Vendndodhja: Prishtine, Kosovë.

1. PROFILI I SHUKOS-it

Shoqata e Ujësjiellësve dhe Kanalizimit të Kosovës (SHUKOS) është një organizatë jofitimprurëse e themeluar nga 7 Kompanitë Rajonale të Ujësjiellësit dhe Kanalizimeve të Kosovës (KRU). Shoqata operon në përputhje me ligjin e OJQ-ve (Nr. 06/L-043) - Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo-Qeveritare. SHUKOS ka organet e veta, Asamblenë dhe Bordin e Drejtorëve, i cili përbëhet nga 7 Kryeshefat Ekzekutivë të Kompanive Rajonale Ujësjiellëse (KRU) plus një përfaqësues nga Ministrite e linjës.

SHUKOS është një koordinator midis Kompanive të Ujit dhe Institucioneve Qeveritare, bashkëpunon me Shoqatat Kombëtare dhe Ndërkombëtare, Donatorët Lokalë dhe Ndërkombëtarë dhe është anëtar i IAWD / IWA ndërsa është pjesë e disa projekteve të donatorëve për zhvillimin e sektorit të ujit në Kosovë.

SHUKOS është aktori kryesor në sektorin e ujit që mbron interesin e KRU-ve në Kosovë dhe në të njëjtën kohë promovon dhe ndihmon zhvillimin e KRU-ve. Merr pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e përgjithshme të shërbimeve të ujësjiellësit dhe kanalizimeve në Kosovë duke përmirësuar kapacitetet e shërbimit të ujit dhe të qëndrueshmërisë financiare, dhe të trajtimit të ujërave të zeza. Aktivitetet e SHUKOS janë të shumta si: mbështetja dhe koordinimit i aktivitetëve dhe politikave të KRU-ve lobimi dhe avokimi për sektorin e ujit, ofrimi i trajnimeve dhe punëtorive, realizimi i fushatave sensibilizuese, shpërndarja e informacionit, organizimi i vizitave studimore, konferencave, seminareve, si dhe organizimi i grupeve punuese bazuar në nevojat e identifikuara nga KRU-të.

Të dhëna rreth SHUKOS:

- Buxheti Vjetor 2021: rreth 115,000.00 euro
- Numri i Certifikatës së Regjistrimit: 5100748-4
- Numri i Përfituesit Publik: 6000672-5
- Numri i TVSH-së: 330437881
- Numri Fiskal: 600120513

SHUKOS, fton kompanitë e auditimit që të shprehin interesimin e tyre për auditim në keto adresa: info@shukos.org dhe abdullah.dërguti@shukos.org, deri më 22.02.2022.

Kohëzgjatja e detyrës:

Kompania e perzgjedhur e auditimit do të kontraktohet nga SHUKOS dhe do të kryej auditim të jashtëm për Shoqatën, për vitin 2021.

Termet e Referencës janë pjesë integrale e kontratës. Raporti përfundimtarë i auditimi të jashtëm duhet të paraqitet më së largu me 07.03.2022

2. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj konsulence është të kryej auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2021, për periudhën, 1 Janar 2021 - 31 Dhjetor 2021, siç kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-043 - Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo-Qeveritare. Auditimi duhet të kryhet nga një Firmë Ligjore e Auditimit (lista e KKRF e Ministrisë së Financave).

3. OBJEKTIVAT DHE FUSHEVEPRIMET

Auditimi i kryer duhet të jetë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISAs). Objektivat kryesore janë marrja e një sigurie të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të pastra nga keqdeklarimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve ose gabimeve.

Përgjegjësitë e auditorit të jashtë për Auditimin e Pasqyrave Financiare 2021:

- Të identifikoj dhe vlerësoj rreziqet e keqdeklarimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve ose gabimeve, përcaktoj dhe kryej procedura të auditimit që u përgjigjen atyre rreziqeve dhe merr dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin.
- Të Siguroj një kuptim të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin në mënyrë që të hartoj procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethana.
- Të vlerësoj përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të bëra nga menaxhmenti.

4. REZULTATET E AUDITIMIT

Kompania e kualifikuar e auditimit do të lëshojë një **Raport të Auditimit në lidhje me rishikimin e Pasqyrave Financiare**. Raporti i auditimit duhet të përmbajë sa vijon:

- Një Opinion që duhet të lëshohet se Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISAs).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit **Nr. 06/L-043**
- Auditori do të lëshojë **një letër menaxhimi/memorandum auditimi** që përmban sa vijon:
 - përmbajtjen dhe fushën e auditimit
 - vëzhgime të rëndësishme mbi aktivitetin e mbuluar nga raporti

Raporti i auditorit duhet të përfshijë gjithashtu letrën e menaxhimit. Organizata mund të lëshojë një konfirmim me shkrim në lidhje me përfaqësimet e bëra në lidhje me Auditimin.

5. TË DHËNAT, PËRGJEGJËSITË, PERSONELI DHE OBJEKTET QË DO TË SIGUROHEN

Kompanisë së auditimit do t'i jepet qasje në të gjitha dokumentet, përfshirë Marrëveshjet përkatëse që SHUKOS ka nënshkruar, raportet dhe çdo informacion tjetër që lidhet me Pasqyrat Financiare dhe që konsiderohet i nevojshëm nga auditori. Stafii SHUKOS do të sigurojë gjithashtu mbështetje të plotë për auditorët në lidhje me informimin mbi dokumentacionin, orientimin, udhëzimin dhe mbështetjen për të fituar qasje në mjediset e nevojshme.

Të dhënat

- Gjuha themelore e të gjithë dokumentacionit është gjuha shqipe dhe gjuha angleze.
- Të gjitha dokumentet do të kthehen në fund të Auditimit. Të dhënat e një natyre konfidenciale do të trajtohen me gjithë maturinë e nevojshme dhe do t'u zbulohen vetëm personave të autorizuar.
- Auditimi do të kryhet nga një auditor i jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të përmendura më lart dhe që është i regjistruar dhe licencuar ligjërisht në Kosovë për të kryer një auditim të tillë.

Shoqata e Ujësjiellësve dhe Kanalizimit të Kosovës

- Një kompani auditimi e cila aplikon për të kryer auditimin do t'i nënshtrohet menjëherë skualifikimit nëse identifikohet ndonjë konflikt i mundshëm interesi ndaj ose në lidhje me SHUKOS.
- Raporti i Auditimit duhet të dorëzohet në fund të detyrës me Letrën e Menaxhimit në dy gjuhë, Shqip.

Personeli

- Auditimi do të kryhet nën përgjegjësinë e përgjithshme të një Auditor i Lartë, i cili ka të paktën 5 vjet përvojë profesionale të auditimit), mbështetur nga ekipi i konsideruar i përshtatshëm nga Kontraktori (me të paktën 2 vjet përvojë profesionale të auditimit).
- Kualifikimet, aftësitë dhe përvoja e përgjithshme dhe specifike profesionale do të merren parasysh gjatë vlerësimit teknik të ofertës. Asnjë staf praktikant nuk duhet të përfshihet në Ekipin e Auditorëve në këtë veprim specifik.

Akomodimi në Zyrë

- Hapësira për zyre ku veprimi i ekspertëve të caktuar të auditimit duhet të sigurohet nga një kompani e zgjedhur e auditimit dhe nuk duhet të jetë përgjegjësi e SHUKOS-it. Sidoqoftë, bazuar në marrëveshje, një hapësirë për zyre brenda ambienteve të SHUKOS-it mund të përdoret vetëm nëse arsyetohet qartë dhe pranohet me përparësi.
- Kompania e auditorëve duhet të sigurojë që auditorët mbështeten dhe pajisen në mënyrë adekuate. Në veçanti, ai do të sigurojë që ka dispozita të mjaftueshme administrative, sekretarie dhe interpretuese për t'i mundësuar auditorëve të përqendrohen në përgjegjësitë e tyre kryesore.

Pajisjet

- Asnjë pajisje nuk duhet të blihet ose të sigurohet te kompania e zgjedhur e auditimit në emër të SHUKOS si pjesë e kësaj kontrate shërbimi.